



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 3367 Prot.

Elbasan, më 10.06.2025

Vendim

Nr 450 Datë 10/06/2025

Për përcaktimin e detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit administrative të administratës së Bashkisë dhe rritjen e efikasitetit të saj, bashkërendimin e aktivitetit të strukturave në realizimin e funksioneve dhe shërbimeve publike, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8,9, 59 e 64 të tij, ligjin 44 datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative”, nenet 28 e 29 të tij,

Vendosa

- 1- Zv/Kryetari i Bashkisë z. Irland Sina, është përgjegjëse për drejtimin, organizimin e punës, ndarjen e detyrave, kontrollin dhe monitorimin, e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik, Kulturës e Turizmit, Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit dhe strukturave vartëse të tyre.
- 2- Në funksion të realizimit të përgjegjësi si më sipër, Zv/Kryetarit z. Irland Sina i delegohen kompetencat si më poshtë:
 - *Të kontrollojë, shqyrtojë dhe nënshkruaj të gjithë korespondencën e krijuar dhe aktet e nevojshme administrative, në funksion të realizimit të përgjegjësi të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.*
 - *Kur për realizimin e funksioneve të përcaktuara në këtë urdhër, është e nevojshme lidhja e kontratave apo marrëveshjeve në të cilat Bashkia është palë, ato mund të nënshkruhen nga zv/kryetari me autorizim të posaçëm të Kryetarit të Bashkisë,*
 - *Kontrollon, miraton e nënshkruan materialet që paraqiten në Këshillin Bashkiak, si relacione, projekt-vendime etj, që kanë lidhje me ushtrimin e përgjegjësi të përcaktuara në këtë urdhër dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të tij*
- 3- Aktet dhe shkresat zyrtare të dala në zbatim të kompetencave të sipërcituara, do të jenë njelloj të detyrueshme, për administratën e Bashkisë dhe njësitë vartëse të saj.
- 4- Ushtrimi i këtyre kompetencave do të bëhet nga data 10.06.2026 deri në një urdhër të dytë.

- 5- Zv Kryetari z. Irland Sina nuk mund të delegojë këto kompetenca tek punonjës apo struktura të tjera.
- 6- Zv/kryetari z. Irland Sina do të raportojë periodikisht, por jo më rrallë se një herë në muaj, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim.
- 7- Ngarkohen zv/kryetari z. Irland Sina dhe administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi si dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias me publikimin e tij.
- 8- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Bashkisë.

**Kryetari
Gledian Llatja**

